

MENDIM NË PAKICË

Mbi votimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës, në lidhje me Vendimin nr.241, datë 24.10.2019, referuar çështjes që i përket kërkesës së drejtuar, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga znj. {...}, gjyqtare dhe njëkohësisht {...} e {...}, për dorëheqjen e saj nga Statusi i Magjistratit.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 24.10.2019 (ditë e enjte), pas shqyrtimit të problematikave përkatëse në pikën e parë të rendit të ditës, në pikën e dytë të tij, me emërtimin “Të tjera”, është përfshirë për tu shqyrtuar në këtë mbledhje edhe shkresë/kërkesa me nr. Prot. 5268, datë 23.10.2019, e depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga gjyqtarja dhe njëkohësisht Kryetarja e {...}, znj. {...}, e cila me anë të kësaj kërkesë, ka paraqitur dorëheqjen e saj nga Statusi i Magjistratit.

Për sa më sipër, nisur nga fakti që kam mbajtur qëndrim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në nenin 66 pikën 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë”...

Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor...

...9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinionin e tij t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit...po parashtroj sa më poshtë argumentet e mia, në lidhje me këtë çështje:

- Për sa i përket aspektit formal procedural më duhet të theksoj që;

Së pari: Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, nuk është respektuar neni 66 pika 4 dhe 5, e ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë”...

Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor...

...4. Mbledhja e Këshillit mund të thirret edhe me kërkesën e jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit, të cilët përcaktojnë në kërkesë edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Kryetari vendos datën dhe orarin e mbledhjes jo më vonë se 7 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

...5. Kryetari siguron respektimin e procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhjeje të Këshillit.

Çfarë dua të referoj është fakti se, Mbledhja Plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor e datës 24.10.2019, u zhvillua në orën 8:30 të mëngjesit dhe kërkesa për dorëheqje e znj. {...}, nuk mund të përfshihej në këtë mbledhje plenare, nisur nga fakti që protokollimi i kësaj kërkesë, ishte **bërë një ditë më parë** (...referuar shkresës 5268 datë 23.10.2019, ditë e mërkurë, rreth

orës 14.00...), duke mos i dhënë logjikisht, kohën e mjaftueshme për tu shqyrtuar dhe përgatitur, Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, si dhe kohën e mjaftueshme për tu marrë në vlerësim dhe shqyrtuar nga anëtarët e tjerë të Këshillit. (...unë personalisht jam vene në dijeni, rreth orës 18.00 të një dite më parë, nga një email i dërguar nga ana e administratës në adresën time zyrtare, në të cilin ishin përfshirë edhe çështjet e rendit të ditës për mbledhjen e ditës së nesërme...)

Së dyti: Kërkesa e znj. {...} për “Dorëheqje nga Statusi i Magjistratit” nuk u përshi në mënyrë të specifikuar, si një pikë më vete në rendin e ditës, në mbledhjen e datës 24.10.2019, kur jo më larg se në mbledhjen e mëparshme plenare, atë të datës 22.10.2019, në rendin e ditës u shqyrtua kërkesa e gjyqtarës/magjistrates zj. {...}, po për të njëjtin shkak, (citoj... në pikën 4, të Rendit të Ditës të datës 22.10.2019 ishte përfshirë “Shqyrtimi i projektvendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”, e cila iu drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë nr.prot.5044, datë 11.10.2019, me motivacion “angazhim në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor”).

Çuditërisht në pikën e dytë të rendit të ditës, të mbledhjes plenare të datës 24.11.2019 është përdorur emërtimi “**Të tjera**”, një emërtim që padashur të marr përsipër të interpretoj gamën e problematikave që mund të përfshihen në përmbajtjen e këtij termi, mund ta shpreh me bindje të plotë që në asnjë rast nuk mund që të përfshijë në përmbajtjen e tij, një kërkesë kaq të rëndësishme dhe që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me statusin e magjistratit. Nisur nga praktika e deritanishme që ka mbajtur Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke i përfshirë si një pikë të identifikuar në rendin e ditës, kërkesat për dorëheqje të magjistratëve, kjo nga ana tjetër i ka shërbyer edhe procesit të transparencës së Këshillit në vendimmarrjen e tij përkundrejt publikut të gjerë (...refero në vendimmarrjet e Këshillit gjatë periudhës 10 mujore të tij...). **Nisur nga sa më sipër, një situatë e tillë ka cenuar pa më të voglin dyshim, parimin e transparencës së vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke krijuar edhe një premisë negative në perceptimin e besueshmërisë dhe profesionalizmit ndaj këtij organi...**

- Për sa i përket aspektit material, po parashatroj sa më poshtë;

Nëse do të vlerësonim nga pikëpamja ligjore situatën e mësipërme, kjo e fundit gjen rregullim në KREUN VIII të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve...”, me titullin “MBARIMI I STATUSIT TË MAGJISTRATIT”.

Sipas **nenit 64 pika 1, germa a**, të ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve...” parashikohet...

Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

Në vazhdim në **nenin 65** të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet sa më poshtë:

1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Siç duket edhe nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, **ligjvënësi ka parashikuar fillimisht një situatë normale për mbarimin e statusit të magjistratit**, duke ja nënshtruar këtë situatë, një procedurë të caktuar ligjore. **Si rregull** kërkesa me shkrim e magjistratit, depozitohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili do të angazhohet më pas, duke u shprehur me një vendimmarrje deklarative, në lidhje me efektet e dorëheqjes të kërkesës përkatëse. **Paragrafi 2 i nenit 65 i ligjit të sipërcituar, shprehet qartazi në lidhje me efektet e dorëheqjes së paraqitur pranë Këshillit, nga ana e magjistratit përkatës, duke e lidhur këtë të fundit edhe me kalimin e një afati kohor të caktuar, i cili në rastin me thjeshtë është rreth 45 ditë.**

Në referim të rastit që shqyrtoi Këshilli, është fakt që kërkesa e dorëheqjes nga ana e gjyqtarës zj. {...} është depozituar në zyrën e protokollit në datën, **datë 23.10.2019 me nr. 5268 Prot.** Si rregull, duke u bazuar edhe në logjikën e ligjvënësit, afati i shqyrtimit të kësaj kërkesë duhet të ishte “...fundi i muajit pasardhës...”, në harkun kohor të dy javëve nga momenti i plotësimit të këtij afati kohor. Po të bëjmë një referim konkret, mbi llogaritjen e afatit të shkresës për dorëheqje të depozituar pranë Këshillit, konstatohet se pas kalimit të ditëve të mbetura të muajit tetor (konkretisht periudha 23-31 tetor, rreth 8 ditë), do të duhej që të kalonte i gjithë muaji pasardhës, muaji nëntor (konkretisht edhe periudha 1-30 nëntor, dmth 30 ditë) dhe pas kalimit të këtij afati 38 ditor dhe brenda harkut kohor të dy javëve (dmth një periudhe 15 ditore, që përkon me gjysmën e parë të muajit dhjetor), do të përmbylej hipotetakisht edhe afati për dhënien e vendimit deklarativ të Këshillit, i cili do të ishte në një hark kohor rreth 53 ditor (...natyrisht që ky është një afat “tavan”, për sa Këshilli mund të shprehet brenda dy javëve dhe jo domosdoshmërisht në fund të këtij afati...)

Siç edhe e theksova më sipër, bëhet fjalë për një **procedurë normale** të parashikuar nga ligji dhe që mund të konfigurohet sipas një **skeme** të tillë;

(1) Statusi i magjistratit mbaron kur.... jep dorëheqjen.....(2) Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës.....(3) Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet... jo më vonë se dy javë..

Problemi qëndron në faktin se shumica e ka justifikuar vendimmarrjen e saj, duke bazuar në **paragrafin 3 të nenit 65** të ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve...”, i cili përcakton se;

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Sipas këndvështrimit tim, mendoj që ligjvënësi në aplikim të përmbajtjes së këtij paragrafi, ka parashikuar edhe mënyrën e mbarimit të statusit të magjistratit, **në një situatë përjashtimore, duke bërë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, nëpërmjet një klauzole përjashtimi dhe që përmbahet në tekstin e këtij paragrafi.**

Konkretisht një *situatë e tillë përjashtimore* ka të bëjë, vetëm **me raste të justifikuara** dhe që duhet të argumentohen nga magjistrati, nëpërmjet **një kërkesë të motivuar** nga ana e tij. Kjo situatë e *detyron Këshillin*, që mos të jetë tashmë **vetëm deklarativ** në vendimmarrjen e tij, por përkundrazi e angazhon këtë të fundit, **që të shqyrtojë** me kujdes **“kërkesën e motivuar”** të *magjistratit* dhe nëpërmjet çmuarjes reale të **“rastit të justifikuar”** që mund të pretendohet nga ky i fundit, të vendosë përfundimisht që ta miratojë apo ta refuzojë kërkesën për dorëheqje. Kjo logjikë del fare qartë, nga analiza që mund ti bëhet përmbajtjes së *paragrafit 3* të nenit të sipërcituar, i cili parashikon termin **“...dhe me miratim të Këshillit...”**, çka e bën të ndryshëm nga parashikimi që ka bërë ligjvënësi në *paragrafin 2* të po këtij neni, i cili parashikon që **“...Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit...”**.

Për pasojë, kuptohet fare qartë **qëllimi i ligjvënësit** në rregullimin e situatës juridike të mbarimit të statusit të magjistratit, në lidhje me raportin që sanksionon ky i fundit, midis rregullit dhe përjashtimit, **pasi në asnjë rast rregulli nuk mund të bëhet përjashtim dhe përjashtimi të bëhet rregull**. Nga njëra anë kemi të bëjmë **me rregullimin e një situatë normale të mbarimit të statusit të magjistratit, ku me kalimin e një afati kohor të arsyeshëm, Këshilli shprehet me një vendim deklarativ dhe nga ana tjetër ligjvënësi ka parashikuar një situatë përjashtimore të mbarimit të statusit, ku pas verifikimit dhe kontrollit të disa elementëve që pretendohen nga magjistrati, të miratojë kërkesën e tij.**

Pikërisht ky rregullim ligjor, e detyron Këshillin që të jetë “i kujdesshëm” në vlerësimin e situatave të tilla, në mënyrë që jo çdo kërkesë e depozituar për mbarimin e statusit të magjistratit, të mund të trajtohet si një kërkesë e motivuar dhe që përbën një rast të justifikuar (rasti përjashtimor), në mënyrë që ky i fundit të miratojë me vendim mbarimin e këtij statusi dhe ti japë dorëheqjes, një efekt juridik të përshpejtuar në kohë.

Dorëheqja e znj. {...}, e cila është depozituar pranë Këshillit, paraqet si shkak të motivuar angazhimin e saj **“...në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor...”**, konkretisht në pozicionin e **“Drejtuësës së Drejtorisë Juridike”** pranë {...}. Natyrisht që pa dashur të hyj **në trajtimin e aspektit subjektiv, mbi natyrën motivuese** të kërkesës për dorëheqje të paraqitur nga magjistrati, nuk mund të lë mënjane trajtimin e këtij rasti në **aspektin objektiv, mbi natyrën** që duhet të paraqesë **“...rasti i justifikuar...”**, si një rast përjashtimor.

Mendoj që pavarësisht **kërkesave të motivuara** apo dhe **shkaqeve të motivuara** që mund të pretendohen nga magjistratët në kërkesat për dorëheqje, këto të fundit shprehin vlerësimin subjektiv të tyre në lidhje me ato shkaqe që pretendojnë, ndërkohë që jo të gjithë rastet që mund të paraqiten përpara Këshillit, mund të përbëjnë për këtë të fundit, **një rast urgjent apo/dhe përjashtimor**. Kjo pasi në referim të përmbajtjes së **paragrafit 3 të nenit 65**, të ligjit 96/2016, Këshilli duhet që të bëjë një analizë të rastit përjashtimor duke bërë çmuarjen e shkaqeve të

motivuar të kërkesës, në mënyrë që më pas të miratojë edhe dorëheqjen e magjistratit me efekte të përsheptuara.

Për sa i përket rastit konkret, pavarësisht se Këshilli nuk ka një praktikë të konsoliduar, në lidhje me tërësinë e shkaqeve që mund të përfshihen në grupin e “shkaqeve të motivuara” për sa i takon rastit të dorëheqjeve, mendoj që krijimi/lidhja e një marrëdhënie të re pune me një institucion jo publik, jashtë sistemit gjyqësor dhe dorëheqja nga funksioni i magjistratit dhe atij drejtues, nuk mund të përbëjë një rast përjashtimor për Këshillin e Lartë Gjyqësor për të miratuar dorëheqjen e magjistratit me efekte të përsheptuara.

Ligjvënësi kur ka përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 65 të ligjit 96/2016 që “...Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarin me shkrim të dorëheqjes.”, ka sanksionuar një rregull të zakonshëm, duke pasur parasysh vijueshmërinë e punës për çështjet që gjyqtari/magjistrati ka në shqyrtim dhe moscënimin e interesit publik (shkaku objektiv) për detyrat e marra përsipër nga magjistratit në misionin e tij për dhënien e drejtësisë. Për këtë arsye duke qenë se ligjvënësi ka parashikuar fillimisht një rregull të përgjithshëm, në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit me dorëheqje (paragr.2 neni 65 i ligjit 96/2016), përjashtimisht ky i fundit ka pranuar edhe mbarimin e këtij statusi për raste të justifikuara, si një klauzolë përjashtimore (paragr.3 neni 65 i ligjit 96/2016).

Në rastin konkret znj. {...} mund të plotësojë kërkesat për të marrë vendimin deklarativ nga Këshilli, për dorëheqjen si gjyqtare dhe mbarimin e statusit të magjistratit bazuar në paragr.2 të nenit 65, por vendimi për miratimin e dorëheqjes së saj nga Këshilli, bazuar në paragr.3 të nenit 65, që në fakt rregullon një klauzolë përjashtimore, e kthen këtë paragraf të ligjit në një rregull dhe rregullin në një përjashtim, rregullim i cili nëse zbatohet në formë të përsëritur nga Këshilli, padyshim që do të krijonte një “precedent negativ”, në kundërshtim të ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve...” dhe do të “deformonte” vullnetin e ligjvënësit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas nenit 147 të Kushtetutës së R Shqipërisë “... siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë...”

Sipas nenit 2 të ligjit 115/2016 (i ndryshuar) “Për Organet e Qeverisjes...”, mbi parimet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili përcakton që; “... Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efiçencës...”

Sipas nenit 89 të ligjit 115/2016 (i ndryshuar) “Për Organet e Qeverisjes...”, mbi administrimin e gjykatave, i cili përcakton që; “...Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme...”, është një organ kushtetues, kolegjal dhe i pavarur. Si një organ relativisht i ri dhe që vjen si rezultat zbatimit të paketës ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, ka një ndër funksionet kryesore të tij atë të “qeverisjes së gjyqësorit”, administrimit, funksionalitetit dhe efiçencës së tij. Në ushtrim të këtyre kompetencave, parësore është detyra dhe përgjegjësia e këtij organi, që mbi të gjitha të garantojë mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe të sigurojë mbrojtjen e interesit publik. Nga këndvështrimi im, Këshilli duhej

të bënte analizën e shkaqeve të motivuara të kërkesës për dorëheqje, pikërisht duke çmuar rëndësinë e këtyre shkaqeve, nën “dritën” e moscënimit të interesit publik. Nga njëra anë si shkak i motivuar paraqitet nga magjistrati, një marrëdhënie e re pune në një institucion jo publik, përkundrejt dhënies së dorëheqjes nga funksioni drejtues në një organ publik dhe mbarimit të statusit dhe largimit nga pozicioni i “gjqqtarit”, një detyrë kjo e rëndësishme dhe e veçantë. Në këtë “konkurrin interesash”, të atyre që parashtron magjistrati si shkaqe të motivuara dhe të rëndësishme që ka për interesin publik vazhdimësia e ushtrimit të detyrës dhe e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, **natyrisht që prevalon mbrojtja e interesit publik**. Pikërisht këtu konsiston edhe roli aktiv i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili duke qenë i vetëdijshëm që nuk mund “**të detyrojë**” apo “**të pengojë**” çdonjërin nga magjistratët, për të kërkuar dorëheqjen nga statusi i magjistratit, e ka në kompetencë të plotë analizën dhe çmuarjen “shkaqeve të motivuara” dhe trajtimin e situatave konkrete si “*raste të zakonshëm*” apo “*raste të justifikuara*”.

Bazuar në situatën konkrete përveç se në pozicionin e gjyqtarës, zj. {...} ishte edhe në rolin e {...} së {...}, ndaj dhe largimi i saj i menjëhershëm në momentin kur sistemi gjyqësor është në një situatë të vështirë, por edhe në vetë gjykatën e {...}, problematika këto që janë relatuar dhe nga vetë znj. {...} për gjykatën të cilën ajo drejtonte, **nuk mendoj që e justifikonte vendimin e Këshillit, në lidhje me miratimin e kërkesës së dorëheqjes si një rast i justifikuar, për shkaqe të motivuara.**

Për më tepër që znj. {...}, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim **të ligjit nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në cilësinë e të qenit kryetare e gjykatës ka qenë një subjekt me prioritet, për të përfunduar procesin e vetingut. Shqyrtimi i menjëhershëm, gati “urgjent” i kërkesës së saj (vetëm një ditë më vonë) nga ana e Këshillit mund të “krijojë përshtypjen” se znj. {...}, nëpërmjet dorëheqjes së menjëhershme mund të ketë dashur që “të shmangë”, një vendim të mundshëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, fakt të cilin nuk do të doja që ta besojta.

Për këtë arsye mendoj që, Këshilli duhet të jetë më i përgjegjshëm, në lidhje me vendimarrje të tilla të cilat nëse “lexohen” gabim nga aktorët e procesit, mund që të krijojnë “precedentë negativë”, mbi vendimarrjen, transparencën dhe integritetin e tij.

Për sa më sipër, shprehja qëndrimin dhe argumentet e mia dhe votova “**KUNDËR**” propozimit për miratimin me efekte të përsheptuara, të dorëheqjes nga statusi i magjistratit, për znj {...}.

Zëvendëskryetari

Maksim Qoku